

VENDIM
Nr.821, datë 5.12.2007

PËR KRIJIMIN E DISA NJËSIVE KRYESORE, FAKULTETEVE TË UNIVERSITETIT
“ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, 41 e vijues të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan:

a) Krijohet Fakulteti i Shkencave të Edukimit nga bashkimi i ish-Fakultetit të Mësuesisë dhe ish-Fakultetit të Shkencave Sociale, i cili të ketë këto departamente:

- Departamentin e Metodologjisë së Mësimdhënies, që krijohet nga bashkimi i Departamentit të Pedagogji-Didaktikës me Departamentin e Arteve të Aplikuara;

- Departamentin e Psikologjisë, Sociologjisë dhe Shkencave të Edukimit, që krijohet nga ish-Departamenti i Psikologjisë dhe Sociologjisë;

- Departamentin e Edukimit Qytetar, që krijohet nga ish-Departamenti i Edukimit Qytetar dhe Gazetarisë.

b) Fakultetit të Shkencave Humane i bashkohet ish-Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe do të ketë në përbërje këto departamente:

- Departamentin e Gjuhësisë, Letërsisë dhe Gazetarisë, që krijohet nga ish-Departamenti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë dhe Seksioni i Gazetarisë, pjesë e ish-Departamentit të Edukimit Qytetar dhe Gazetarisë;

- Departamentin e Historisë dhe Gjeografisë;

- Departamentin e Gjuhëve të Huaja, që krijohet nga bashkimi i ish-Departamentit të Gjuhës Angleze dhe ish-Departamentit të gjuhës gjermane, frënge dhe Italiane.

c) Fakultetit të Shkencave të Natyrës iu bashkohet ish-Shkolla e Lartë e Infermierisë dhe do të ketë në përbërje këto departamente:

- Departamentin e Matematikës;

- Departamentin e Fizikës;

- Departamentin e Biologjisë dhe të Kimisë;

- Departamentin e Infermierisë.

2.Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për vitin akademik 2007-2008, do të vazhdojë të ofrojë të njëjtat programe studimi, që ka ofruar me fillimin e këtij viti akademik.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha